



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr. 861 Prot

Vau Dejës, më 13.02.2023

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. Mark Bisha

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë Projekt-Vendimin, për:

“Miratimin e Marrëveshjes për Krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës Dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz”

Me respekt,

KRYETAR
Mark BABANI



Miratoi:

Kristinë Shtatri: Përgjegjës i Sektorit të Asistencës Ligjore, Çështjeve Gjyqësore dhe Kontratave

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE KONTRATAVE
Adresa. Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT – VENDIM

Nr. 01 Datë 13.02.2023

PËR

**“MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË
KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DATË
19.01.2023, LIDHUR NDËRMJET BASHKISË VAU-DEJËS DHE MINISTRISË SË
ENERGJISË DHE INFRASTRUKTURËS DHE BASHKIVE MALËSI E MADHE, PUKË
DHE FUSHË-ARRËZ”**

Në mbështetje të Nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenit 9, Pikës 1 dhe 5 të Nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarët”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 302, datë 11.05.2022, “Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”; Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës – Kanalizimeve datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës, dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe Bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz; Shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM, Nr. 67/2 Prot, datë 06.02.2023, “Për Miratimin e Marrëveshjes SKP-UK në Këshillin Bashkiak”, pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në marrëveshje, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizimeve datë 19.01.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës, dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe Bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz.

2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si aksionar i vetëm i shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime Vau Dejës” sh.a, që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizime datë 19.01.2023, që pas krijimit të Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime Vau Dejës” sh.a, për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë asetet që shoqëria aktualisht ka, tek shoqëria e re aksionare SKP-UK që do të krijohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Mark BABANI



Konceptoi:

Specialiste/ Sektori i Asistencës Ligjore
Fatjona Kovaçi

Miratoi:

Përgjegjëse/ Sektori i Asistencës Ligjore
Kristinë Shtatri